

L I G J
Nr.8005, datë 4.10.1995

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET
SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Pas nenit 26 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, shtohet neni 26/a me këtë përmbajtje:

“Farmacitë dhe mjekët e familjes ose të përgjithshëm për moszbatim të kontratës paguajnë gjobë në masën nga 1 000 deri në 10 000 lekë.

Gjobat vendosen nga specialistët dhe drejtuesit e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të degëve të varësisë së tij në rrethe. Ekzekutimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1259, datë 30.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha